

Anoplophora glabripennis (Motschulsky)

Brumbull aziatike me brirë të gjatë

Insekti: Coleoptera: Cerambycidae

Bimët nikoqire

Bima në të cilën gjendet insekti më së shumti në Evropë është *Acer spp.* Gjithashtu gjendet edhe në *Aesculus hippocastanum*, *Alnus*, *Betula*, *Fraxinus*, *Malus*, *Morus alba*, *Platanus*, *Populus*, *Salix*, *Ulmus*, *Prunus*, *Pyrus*, *Rosa*. Gjithashtu është në gjendje të ushqehet me pemë të tjera gjetherëse.

Shpërndarja- Shtrirja gjeografike

Evropë: Austri, Francë, Gjermani, Itali, Zvicër, BM, Finlandë.

Azi: Kinë, Korea e Jugut, Korea Veriore.

Amerikë Veriore: SHBA, Kanadë.

Simptomat

Vrima ovale ose rumbullake në lëvore, ku janë hedhur vezët. Vrima të mëdha rumbullake (10 mm) që mund të ndodhen kudo në dru duke përfshirë degët, trungun dhe rrënjët e ekspozuara. Masa me zhveshje të drurit (brejtje) që dalin nga vrima dalëse në bazë të drurit. Larvat formojnë galeri nën lëvore dhe tunele (10-30 cm) në dru.

Biologjia dhe morfologjia

Për zhvillimin e një gjenerate nevojiten 1-2 vite, varësisht nga kushtet klimatike. Zakonisht, të rriturit mbeten në drurin nga i cili dolën, ose fluturojnë në distanca të shkurtra pranë drunjve të

afërt, dhe ushqehen atje me gjethe, petiole dhe lëvore të reja. Vezët vendosen një nga një nën lëvore në një trung apo degë. Larva ushqehet në shtresën kamiale të lëvres dhe më vonë hyn në indet me dru. Larva është rezistente ndaj të ftohtit, mund të mbijetojë deri në -40°C. Vezët, larvat dhe krizolidët mund të mbijetojnë dimrin.

Mënyrat Rrugët e përhapjes

Distanca të shkurtra: të rritur që fluturojnë (rrallë më shumë se 600 m).

Distanca të gjata: materialet e paketimit nga druri (paletat, arkat, paketat etj.).

Periudha e marrjes së mostrave dhe inspektimit

Glabripennis mund të zbulohet duke mbledhur dru të infektuar dhe fragmente druri me dëmtues në të gjitha fazat e ciklit jetësor. Mostrat mblidhen gjatë periudhës së vegetacionit të bimëve pritëse.



A. glabripennis të gjitha fazat e zhvillimit. Foto: K. R. Law, USDA APHIS PPQ, forestryimages.org.



Dëmtimet e shkaktuara nga *A. glabripennis*. Foto: T. B. Denholm, Departamenti i Bujqësisë New Jersey, Bugwood.org.



Dëmtimet e shkaktuara nga *A. glabripennis*. Foto: F. Hérard, Laboratori Evropian i Kontrollit Biologjik, Montferrier-sur-Lez.